



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

# **ANALIZA E PUNËS SË ISHMT-së 2020**

TIRANË 2021

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

<b>1. ARRITJET KRYESORE</b> .....	<b>3</b>
<b>2. OBJEKTIVAT KRYESORE</b> .....	<b>4</b>
<b>AKTIVITETET E REALIZUARA PËR 2020</b> .....	<b>4</b>
<b>3. INSPEKTIME PËR RESPEKTIMIN E KRITEREVE LIGJORE</b> .....	<b>4</b>
<b>3.1 Inspektime për mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimore.</b> .....	<b>5</b>
<b>3.1.1 Metrologjia</b> .....	<b>5</b>
<b>3.1.2. Produkte elektrike</b> .....	<b>6</b>
<b>3.1.3 Produkte mekanike</b> .....	<b>6</b>
<b>3.1.4 Qelq/këpucë/lodra &amp; siguria e përgjithshme</b> .....	<b>7</b>
Inspektimet për detergjentët.....	<b>8</b>
<b>3.2. Inspektime për respektimin e të drejtavë të pronësisë intelektuale</b> .....	<b>9</b>
<b>3.2.1. Inspektimi mbi të drejtën e autorit</b> .....	<b>9</b>
<b>3.2.2. Inspektime mbi pronësinë industriale</b> .....	<b>10</b>
<b>3.3. Inspektime për kontrollin e zbatimit të protokolleve COVID-19</b> .....	<b>10</b>
<b>4. AKTIVITETEVE SENSIBILIZUESE/INFORMUESE</b> .....	<b>10</b>
<b>5. NGRITJA DHE FORCIMI I KAPACITETETEVE</b> .....	<b>13</b>
<b>6. MBËSHTETJE PËR PËRMIRËSIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E VEPRIMTARISË TË ISHMT-SË</b> .....	<b>14</b>
<b>7. DETYRAT E PAREALIZUARA OSE TË REALIZUARA PJESËRISHT</b> .....	<b>15</b>
<b>7.1. Arsyet e mosrealizimit të çështjeve të parashikuara për vitin 2020</b> .....	<b>15</b>
<b>8. BURIMET NJERËZORE</b> .....	<b>17</b>
<b>8.1 Disiplina në punë, rekordet e orareve të punës</b> .....	<b>17</b>
<b>8.2 Performanca sipas kritereve</b> .....	<b>17</b>
<b>8.3 Masa disiplinore të marra</b> .....	<b>17</b>
<b>8.4 Ngritje në detyrë, lëvizje paralele</b> .....	<b>17</b>
<b>8.5 Ankesat</b> .....	<b>17</b>
<b>9. MASAT E NDËRMARRA LIDHUR ME TASK FORCËN E ANTIKORRUPSIONIT</b> .....	<b>18</b>
<b>10. PLANI I PUNËS PËR VITIN 2021</b> .....	<b>18</b>
<b>11. PROBLEMATIKAT</b> .....	<b>19</b>

## 1. ARRITJET KRYESORE

- ✓ Ndikimi në uljen e mos-konformiteteve të produkteve joushqimore si dhe në respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nëpërmjet inspektimeve të kryera gjatë vitit 2020. Inspektimet e vazhdueshme dhe të rregullta në treg, të shoqëruara nga fushata sensibilizuese, kanë ndihmuar në përpjekjet institucionale për të arritur këtë Objektiv. (Janë kryer në total **1649 inspektime** nga të cilat 1215 inspektime të programuara<sup>1</sup> dhe 434 jashtë programit mbi bazë ankimi<sup>2</sup>. Janë vendosur **318 masa administrative në total** nga të cilat 249 paralajmërimë, 45 gjoba dhe 24 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar **9799 produkte** nga të cilat 491 kanë qenë jo në konformitet (Tab.1)
- ✓ Bërja e evidencave të ISHMT-së në tregun e produkteve joushqimore dhe në fushën e respektimit të pronësisë intelektuale, si një institucion që ka në fokus kontrollin e respektimit të kriterëve ligjorë sipas fushës së veprimtarisë së tij. Kjo është arritur nëpërmjet informimit të operatorëve ekonomikë, të konsumatorëve nëpërmjet informacionit në adresën zyrtare [www.ishmt.gov.al](http://www.ishmt.gov.al), rrjetet sociale, si dhe nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike, ku ky institucion ka qenë prezent për sqarime të konsumatorëve mbi disa produkte që janë të ndjeshëm për ta. Nga inspektimet janë informuar **1013 subjekte** dhe përfaqësues të ISHMT-së kanë qenë prezent në mediat elektronike në **5 emisione televizive**.
- ✓ Informimi i konsumatorëve mbi të drejtat e tyre për të disponuar produkte/pajisje/instalime të sigurta dhe informimin e operatorëve ekonomikë, për të respektuar kërkesat ligjore të përcaktuara në legjislacionin aktual, për të ofruar në treg produkte të sigurta si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Kjo është arritur nëpërmjet aktiviteteve, trajnimeve të ndryshme të organizuar me pjesëmarrjen e grupeve të interesit, të fletëpalosjeve, botimeve informuese, emisioneve, intervistave televizive, etj. Në total janë realizuar **11 aktivitete sensibilizuese**.
- ✓ Dhënia e kontributit për kontrollin e zbatimit të protokolleve të sigurisë anti-Covid, si pjesë e Task Forcës<sup>3</sup> në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të krijuar për shkak të Covid 19. Janë kryer në total **11940 kontrole të subjekteve**.

---

<sup>1</sup> “Inspektim i programuar” është inspektimi që kryhet në bazë të programit të miratuar të inspektimit për çdo inspektorat qendror apo vendor

<sup>2</sup> Inspektim jashtë programit konsiderohet inspektimi kur: a)nga monitorimi dhe mbikëqyrja e kryer nga inspektorai , nëpërmjet analizës periodike dhe të vazhduar të të dhënave apo informacioneve, lind dyshimi i arsyeshëm për shkeljen e kërkesave ligjore; b) ndodhja e ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve kanë cenuar apo mund të cenojnë jetën ashëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin; c) si pasojë e informacionit të marrë nga një institucion publik shqiptar apo një shtet tjetër a njëorganizatë ndërkombëtare.; d) në bazë të një denoncimi apo informacioni të marrë nga të tretët, nëse krijohet dyshimi i arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore nganjë subject; e) në kushtet e flagrancës; etj.

<sup>3</sup> Task Forcë e ngritur me Vendimin Nr.15, datë 25.4.2020 "Për krijimin e Task-Forcës për garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19".

- ✓ Fuqizimi i ISHMT-së dhe rritja e kapaciteteve njerëzore. Në qershor 2020 kemi miratimin e Strukturës së re të ISHMT-së<sup>4</sup> ku numri i punonjësve u rrit nga 59 në 80 (Tab.2) . Në shtator 2020 kemi kalimin në ambiente të reja pune duke e bërë më efektive punën e këtij institucioni. Gjatë 2020 janë kryer në total **15 trajnime ku janë trajnuar 52 punonjës.**
- ✓ ISHMT ka dhënë kontributin duke qenë pjesë e grupeve të punës në: hartimin e 3 (tre) draft ligjeve, 1(një) draft VKM , 2 rregullore për institucionin dhe në raportimet për Kapitullin 1, 7 dhe 28 si pjesë e GNP.

## 2. OBJEKTIVAT KRYESORE

### Objektivi kryesor:

Përmirësimi i sigurisë së produkteve për konsumatorët dhe respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale.

Objektivi 1: Zbatimi i kërkesave ligjore nga subjektet konform legjislacionit në fuqi për ofrimin e produkteve, pajisje/instalime të sigurta për konsumatorin si dhe për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Objektivi 2: Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë mbi kriteret ligjore që duhet të zbatohen në fushën e sigurisë së produkteve joushqimore, pronësisë intelektuale si dhe të konsumatorëve mbi të drejtat e tyre.

## AKTIVITETET E REALIZUARA PËR 2020

Për arritjen e objektivave, ISHMT ka punuar për përmbushjen e aktiviteteve të mëposhtme:

### 3. INSPEKTIME PËR RESPEKTIMIN E KRITEREVE LIGJORE

**Në total nga ISHMT gjatë kësaj periudhe janë kryer 1649 inspektime nga të cilat 1215 inspektime të programuara dhe 434 jashtë programit mbi bazë ankimi. Janë vendosur 318 masa administrative në total nga të cilat 249 paralajmërime, 45 gjoba dhe 24 masa urgjente (bllokim, shkatërrim). Janë kontrolluar 9799 produkte nga të cilat 491 kanë qënë jo në konformitet. (Tab.1)**

<sup>4</sup> Urdhër i Kryeministrit Nr.73, datë 01.06.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”.

### 3.1 Inspektime për mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimore.

Inspektimet për mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimore përfshijnë kontrollin e respektimit të kërkesave ligjore për metrologjinë, për produktet mekanike, produktet elektrike, qelq/këpucë/lodra & siguria e përgjithshme. Gjatë vitit 2020 janë kryer në total 1253 inspektime nga të cilat 840 inspektime të planifikuara dhe 413 inspektime jashtë programit të nxitura kryesisht nga ankesat. Janë vendosur 282 masa administrative në total nga të cilat 234 paralajmërime, 24 gjoba dhe 24 masa urgjente (bllokim , shkatërrim). Janë kontrolluar 9799 produkte nga të cilat 491 kanë qënë jo në konformitet.

#### 3.1.1 Metrologjia

*Inspektimet në fushën e metrologjisë për vitin 2020 përfshijnë inspektimet për parapaketimet, instrumentat matëse ligjërisht të kontrolluara në përdorim dhe të vendosura në treg. Në total janë kryer 542 inspektime nga të cilat 416 të programuara dhe 126 të pa programuar mbi bazë ankese. Janë vendosur në total 4 masa administrative nga të cilat 1 paralajmërim dhe 3 gjoba.*

#### Inspektime për parapaketim

Gjatë vitit 2020 sektori i Metrologjisë ka kryer **360 inspektime** të subjekteve që tregtojnë me pakicë produkte të paketuara, të subjekteve prodhues dhe importues të parapaketimeve. Gjatë inspektimeve të produkteve të parapaketuara është bërë edhe kontrolli i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara që kanë në përdorim prodhuesit apo importuesit e produkteve të parapaketuara (kryesisht peshore dhe dozatorë).

Janë kontrolluar **1229 produkte** nga të cilat 1 produkt ka qënë jo në konformitet. Është marrë **1(një) masë administrative** me vendim gjobë. Gjithashtu janë kontrolluar edhe **933 instrumente matëse** ligjërisht të kontrolluara në përdorim nga prodhuesit apo importuesit e produkteve të parapaketuara. Për këtë kategori produktesh nuk janë konstatuar produkte jo në konformitet.

#### Inspektime për Instrumentat matëse ligjërisht të kontrolluara që vendosen në treg

Gjatë vitit 2020 sektori i Metrologjisë ka kryer **15 inspektime** të subjekteve që importojnë apo prodhojnë instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara. Janë kontrolluar 10 tipe instrumentesh matëse, nga të cilat 3 kanë rezultuar jo në konformitet. Është marrë **1(një) masë administrative** me vendim gjobë. Tabela e mëposhtme, paraqet të dhënat për këto lloj inspektimesh.

#### Inspektime për instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, në përdorim

Gjatë vitit 2020 sektori i Metrologjisë ka kryer 167 inspektime të subjekteve që kanë në përdorim instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara, kryesisht distributorë karburanti dhe gazi dhe peshore

automobilistike. Janë kontrolluar 7 peshore automobilistike, 697 pistoleta karburanti dhe 123 pistoleta gazi. Janë marrë në total 2 masë administrative nga të cilat 1 masë administrative me vendim gjobë dhe 1 paralajmërim, si dhe janë bllokuar 35 pistoleta karburanti, për të cilat është lënë detyrimi për riverifikim.

### 3.1.2. Produkte elektrike

*Inspektimet e produkteve elektrike për vitin 2020 përfshijnë inspektimet për produkte që mbulohen nga një rregull teknik si: frigoriferë, makina larëse, kondicionerë, furra shtëpiake, aspiratorë, aparate marrëse televizive, si dhe produkte që nuk mbulohen nga një rregull teknik si :adaptorë, priza dhe spina shtëpiake, etj.*

Gjatë vitit 2020, në këto grup-produkte janë kryer në total **78 inspektime**<sup>5</sup> nga të cilat 74 kanë qenë të programuara dhe 4 janë kryer jashtë programit mbi bazë ankimi. Numri i produkteve të kontrolluara për sa i përket markimit CE ka qenë **4798 produkte** nga të cilat 33 kanë rezultuar jo në konformitet, ndërsa për sa i përket shoqërimit të produkteve me Deklaratat përkatëse EU të Konformitetit janë kontrolluar 274 produkte nga të cilat 7 kanë rezultuar jo në konformitet. Bazuar në këto gjetje u mor masa e ndalimit të tregtimit për 30 produkte (karikuesa, llamba, invertera, UPS, ndricuesa dekorativë etj.), në total mbi 2000 njësi. Janë vendosur **11 masa administrative** nga të cilat 1 (një) gjobë, 5 paralajmërim dhe 5 masa urgjente.

### 3.1.3 Produkte mekanike

*Në fokus të inspektimeve për këtë vit kanë qenë ashensorët dhe makineritë. Në total janë kryer **463 inspektime** nga të cilat 274 jashtë programit mbi bazë ankimi. Janë vendosur **233 masa administrative** gjithsej nga të cilat 219 paralajmërim, 1 masë urgjente dhe 13 gjoba.*

#### Inspektime për ashensorët

Gjatë vitit 2020 sektori i Produkteve Mekanike ka kryer **425 inspektime** (në bashkëpunim me sektorin e produkteve elektrike) të subjekteve që kanë në përdorim ashensorë, apo vendosin në treg (instalojnë apo importojnë) ashensorë dhe komponentët e sigurisë për ta. Janë marrë në total **230 masa administrative** nga të cilat 13 gjoba dhe 216 paralajmërim dhe 1(një) masë urgjente.

---

<sup>5</sup> Në zbatim të Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011“Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, Ligjit nr.68/2012 “Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji” , VKM Nr. 1061, datë 23.12.2015, Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuarasi dhe rregullave teknike të miratuar për disa grup produktesh (kondicionerët e ajrit, makinat larëse, pajisje frigoriferike për përdorim shtëpiak, tharëse për përdorim shtëpiak, furra shtëpiake dhe aspiratorët thithës).

Duke qenë se shkalla e informacionit që kanë komuniteti, bizneset dhe përdoruesit e tjerë të ashensorëve në lidhje me sigurinë e ashensorëve dhe detyrimet ligjore përkatëse, është shumë e ulët, janë organizuar një sërë takimesh shpjeguese me grupe të ndryshme interesi, trajnime, etj. si dhe janë shpërndarë materiale informuese.

Gjithashtu ka filluar ngritja e regjistrit kombëtar të ashensorëve dhe gjatë vitit 2020 **janë regjistruar 550 ashensorë**.

### Inspektimi i makinerive

Gjatë vitit 2020 sektori i Produkteve Mekanike ka kryer **38 inspektime** të subjekteve që vendosin në treg makineri. Janë marrë në total **3 masa administrative** paralajmërim.

#### **3.1.4 Qelq/këpucë/lodra & siguria e përgjithshme**

*Gjatë vitit 2020 në fokus të inspektimeve të këtij sektori kanë qenë lodrat, produktet detergjentë, mbrojtja e konsumatorit<sup>6</sup> dhe siguria e përgjithshme . Në total janë kryer **167 inspektime** nga të cilat 161 të programuara dhe 6 jashtë programit të nxitura nga ankesat. Janë vendosur në total **34 masa administrative** nga të cilat 9 paralajmërimë, 7 gjoba dhe 18 masa urgjente. Janë kontrolluar **1308 produkte** në total nga të cilat 75 kanë qenë jo në konformitet.*

### Inspektimet për sigurinë e lodrave

Gjatë vitit 2020 janë realizuar **48 inspektime** të operatorëve ekonomikë kryesisht importues por edhe shpërndarës të produkteve lodra<sup>7</sup>. Në total përgjatë vitit 2020 janë kontrolluar **582 produkte** nga të cilat 40 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur **25 masa administrative** nga të cilat janë vendosur 7 gjoba dhe 18 masa urgjente.

Në kuadër të festave të fundvitit, ISHMT ka realizuar kontrole pranë operatorëve ekonomikë përgjegjës për vendosjen në treg të këtyre produkteve, duke qenë se kjo periudhë përkon edhe me nivelin më të lartë të bërjes së disponueshme të këtyre artikujve për konsumatorët. Kështu, gjatë muajit Dhjetor janë vendosur nën **masën e ndalimit të tregtimit 2500 njësi (27 artikuj të ndryshëm)**. Informacioni mbi lodrat si foto/kod/barkod/numër artikulli/kategoria e riskut, u publikua në faqen zyrtare të ISHMT për të informuar publikun e gjerë. Po kështu u realizuan disa dalje në media kombëtare në emisione të dedikuara për Konsumatorët, për të rritur kështu ndërgjegjësimin e prindërve për kujdesin që duhet të tregojnë në përzgjedhjen e lodrave sa më të

<sup>6</sup> Në zbatim të Ligjit nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit“, i ndryshuar.

<sup>7</sup> Në zbatim të Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe VKM Nr. 262/2013 Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e lodrave”.

sigurta për fëmijët e tyre, duke kontrolluar markimet përkatëse dhe paralajmërimet, si dhe masat e marra nga ISHMT për të garantuar sigurinë e konsumatorëve lidhur me këto produkte.

#### Inspektimet për veshjet e këmbës

Në lidhje me veshjet e këmbës<sup>8</sup> janë kryer **33 inspektime për etiketimin**, ku janë kontrolluar 350 produkte nga të cilat 9 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur **3 masa administrative** paralajmërim, për shkelje të kërkesave ligjore.

#### Inspektimet për mbrojtjen e konsumatorëve

Janë realizuar **23 inspektime** ku janë kontrolluar rreth 8 produkte për përmbushjen e detyrimit të informacionit në gjuhën shqipe, në përputhje me nenin 8,12 të Ligjit Nr.9902 datë 17.04.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar. Nga këto janë konstatuar 4 produkte jo në konformitet, dhe si rezultat janë vendosur **2 masa administrative** paralajmërim dhe detyra për korrigjimin e shkeljeve.

Kategoria e produktit e përfshirë në këto inspektime ishin maskat artizanale, produkt i përhapur në tregje për shkak të pandemisë Covid-19. Produktet u kontrolluan për informacionin e nevojshëm që duhet t'u disponohet konsumatorëve referuar rekomandimeve dhe marrëveshjes së Komisionit Europian për maskat për komunitetin (CWA 17553). Subjektet u këshilluan për kriteret që maskat artizanale, si dhe të mbrojtjes personale duhet të përmbushin<sup>9</sup>.

#### Inspektimet për sigurinë e përgjithshme (veshjet e fëmijëve dhe lodrat në parqe)

Gjatë vitit 2020 janë kryer **27 inspektime** për sigurinë e përgjithshme, nga të cilat 21 për veshjet e fëmijëve dhe 6 për lodrat në parqe. Gjatë këtyre inspektimeve janë kontrolluar **26 pajisje** lodra/pajisje në parqe në përputhje me standardet referuese që mbulojnë sigurinë e tyre<sup>10</sup>, nga të cilat 8 kanë rezultuar jo në konformitet. Për subjektet u la afat për marrjen e masave korrigjuese dhe përcjelljen e provave për zbatimin e detyrave të lëna për t'u realizuar. Sa i përket veshjeve të fëmijëve janë kontrolluar **168 produkte** nga të cilat 2 janë konstatuar jo në përputhje me standardin EN 14682 : 2014.

Në total janë vendosur **2 masa administrative** paralajmërim, për shkelje të kërkesave ligjore.

#### Inspektimet për detergjentët

Në lidhje me detergjentët<sup>11</sup> janë kryer **36 inspektime** për etiketimin e detergjentëve", ku janë

<sup>8</sup> Në zbatim të Ligjit Nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" dhe VKM Nr. 222, datë 28.3.2012 „Për miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët”.

<sup>9</sup> [https://www.cencenelec.eu/research/cwa/documents/cwa17553\\_2020.pdf](https://www.cencenelec.eu/research/cwa/documents/cwa17553_2020.pdf).

<sup>10</sup> VKM Nr.383/2020 Për miratimin e listës së standardeve me karakter referues për sigurinë e lodrave të vendosura në ambiente publike dhe private, EN1176.

<sup>11</sup> Në zbatim të Ligjit Nr.10216/2010 "Për Detergjentët" dhe Vkm Nr.669/2011 "Për Etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për Detergjentët”.



kontrolluar **174 produkte** nga të cilat 12 kanë rezultuar jo në konformitet. Janë vendosur **2 masa administrative** paralajmërim , për shkelje të kërkesave ligjore.

### **3.1.5. Aktivitete të tjera në fushën e inspektimit të produkteve joushqimore**

Në Shkurt 2020, është realizuar **procedura e shkatërrimit të produkteve joushqimore** (lodra) të cilat kanë rezultuar në jo në konformitet me kërkesat minimale të sigurisë sipas legjislacionit në fuqi “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe VKM Nr.262/2013 “Për sigurinë e Lodrave”. Janë shkatërruar 2 mijë produkte në përputhje me VKM Nr. 742, datë 20.11.2019 “Për përcaktimin e Rregullave dhe të Procedurave të shkatërrimit të produkteve”.

Në kuadër të bashkëpunimit me DPD, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve/ISHMT ka vijuar kontrollin dhe ka dhënë kontributin e saj në vijim të kërkesave nga DPD **për kontrollin formal dhe të dokumentave të produkteve joushqimore që kalojnë në pikat doganore**. Nga ana e ISHMT-së është ofruar asistencë teknike për vlerësimin e dokumentacioneve dhe markimit CE, të cilat janë kritere të detyrueshme për vendosjen në treg sipas Ligjit Nr.10489/2011, kryesisht për produkte mekanike, elektrike dhe lodra të deklaruara për t’u vendosur për qarkullim të lirë.

**Krijimi i software**, mbështetur nga Projekti No. EuropeAid / 137616 / IH / SER / AL, që do të shërbejë për hedhjen e të gjitha të dhënave në lidhje me inspektimet e kryera nga ISHMT , operatorët ekonomikë, si dhe do të shërbejë për krijimin e bazës të të dhënave për krijimin e Regjistrisë Kombëtare të Ashensorëve dhe të instrumentave matëse ligjërish të kontrolluara. Krijimi i këtij programi dhe hedhja e të dhënave në të do të shërbejë edhe për përpilimin e një metodologjie efektive të vlerësimit të riskut për produktet si dhe për bizneset. Janë kryer takime konsultative nga ana e IKUB-it me përfaqësues të ISHMT-së për finalizimin e software, trajnime online të stafit të ISHMT-së nga IKUB për përdorimin e këtij software. Është përfunduar krijimi i software dhe pritet aprovimi final i tij nga AKSHI.

## **3.2. Inspektime për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale**

Inspektimet për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale përfshijnë inspektimet për Pronësisë Industriale dhe për të Drejtën e Autorit dhe të drejtave të tjera lidhur me to.

*Gjatë vitit 2020 janë kryer në total **396 inspektime** nga të cilat 375 kanë qenë inspektime të programuara dhe 79 inspektime të paprogramuara, mbi bazë ankese. Janë vendosur **36 masa administrative** nga të cilat 21 gjoba dhe 15 paralajmërime.*

### **3.2.1. Inspektimi mbi të drejtën e autorit**

Në fokus të inspektimeve të Sektorit të të drejtavë të autorit kanë qënë: Inspektimi i programeve kompjuterike, veprave audiovizuale, fotokopje, shtëpi botuese, shtypshkronja, librari.

Gjatë vitit 2020, janë kryer në total **384 inspektime**<sup>12</sup>, nga të cilat 9 kanë qënë të nxitur nga ankesa. Janë informuar subjekte. Janë vendosur **28 masa administrative** nga të cilat 13 gjoba dhe 15 paralajmërime.

### 3.2.2. Inspektime mbi pronësinë industriale

Inspektimet mbi pronësinë industriale janë inspektime që kryhen vetëm mbi bazë ankimi nga subjekte të ndryshme në zbatim të ligjit Ligjit organik Nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar. Gjatë vitit 2020 ka patur një rritje të numrit të ankesave të paraqitura në ISHMT për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale krahasuar me vitin 2019. Gjithsej 14 ankesa për shkelje të të drejtave mbi markat tregtare. Janë kryer **12 inspektime** dhe janë vendosur **8 masa administrative** gjobë.

### 3.3. Inspektime për kontrollin e zbatimit të protokolleve COVID-19

Në zbatim të Vendimit Nr.15, datë 25.4.2020 “Për krijimin e Task-Forcës për garantimin e zbatimit të protokolleve të sigurisë në kuadër të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19” janë realizuar :

- Takime me Prefektin e Tiranës, drejtues i Task Forcës;
- Përcaktimi i metodologjisë së inspektimeve;
- Ngritja e grupeve inspektuese;
- Ndarja e zonave të inspektimit;
- Realizimi i inpektimeve/kontrolleve në terren për zbatimin e protokolleve të sigurisë anti-Covid.

**Janë kryer gjithsej 11940 inspektime** për kontrollin e zbatimit të protokolleve të sigurisë anti – Covid. Nga inspektimet e kryera ka rezultuar se **2421 subjekte i zbatojnë vetëm pjesërisht masat** për parandalimin e COVID –19. Këto subjekte janë këshilluar për zbatimin e protokolleve të sigurisë, në raste të caktuara janë referuar për masë administrative gjobë. **19 subjekte janë referuar për masa administrative** pranë organeve kompetente.

## 4. AKTIVITETEVE SENSIBILIZUESE/INFORMUESE

Në total nga ISHMT gjatë vitit 2020 janë realizuar **11 takime për informimin e operatorëve ekonomikë dhe konsumatorëve, pjesmarrje në 5 emisione televizive, printimi dhe shpërndarja e 2 fletëpalosjeve informuese.**

<sup>12</sup> Në zbatim të Ligjit Nr. 35/2016 datë 31.03.2016 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtave të lidhura me to” për subjektet /përdoruesit e programeve kompjuterike.

- Takimi “Ashensorët, ndryshimet ligjore dhe roli i ndërtuesve” me fokus ndryshimet ligjore të ashensorëve dhe roli i ndërtuesve , organizuar më 30 Janar 2020.
- Diskutim online “Roli dhe funksionimi i Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqytjes së Tregut” në bashkëpunim me Qendrën “Konsumatori Shqiptar” -15 Maj 2020.
- Diskutim online “Certifikimi dhe regjistrimi i ashensorëve - Masat që duhet të marrin njësitë e qeverisjes vendore” në bashkëpunim me Qendrën “Konsumatori Shqiptar” -19 Maj 2020.
- Diskutim online “Produktet elektrike dhe lodrat” në bashkëpunim me Qendrën “Konsumatori Shqiptar” – 20 Maj 2020.
- Diskutim online “E-commerce”, në bashkëpunim me Qendrën “Konsumatori Shqiptar” – 22 Maj 2020.



- Diskutim online “Ashensorët, detergjentët, parapaketimet dhe instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara”, në bashkëpunim me Qendrën “Konsumatori Shqiptar” – 25 Maj 2020.
- “Çertifikimi dhe regjistrimi i ashensorëve - Masat që duhet të marrin njësitë e qeverisjes vendore” - 2 Qershor 2020.
- Takim online “Roli dhe detyrimet ligjore të importuesve, instaluesve, mirëmbajtësve dhe trupave të miratuara në sigurinë që ofrojnë ashensorët”, në bashkëpunim me Qendrën “Konsumatori Shqiptar”– 9 Korrik 2020.
- Diskutim online “Standardet e Lodrave dhe kërkesat thelbësore të sigurisë”. Detyrimet e Shqipërisë dhe shtetit shqiptar në kuadër të anëtarësimit në BE.
- Takimi online me temë: “Tregtimi i lodrave në përputhje me legjislacionin shqiptar, problematikat e konstatuara dhe sfidat për të ardhmen” organizuar më 23 Dhjetor 2020 në kuadër të festave të fundvitit, periudhë në të cilën produktet lodra janë më shumë se kurrë të

pranishme në treg. Të ftuar në këtë aktivitet ishin operatorët ekonomikë, përgjegjës për vendosjen në tregun Shqiptar të këtyre produkteve. Takimi kishte për qëllim, sjelljen në vëmendje të kritereve që duhet të përmbushin këto artikuj për të garantuar sigurinë e fëmijëve, si dhe krijimin e një hapësire për operatorët ekonomikë për t'u qartësuar mbi detyrimet që parashikon legjislacioni në fuqi, diskutimin e problematikave të hasura si dhe sfidat që paraqet e ardhmja për këtë treg.

- Takim “Pronësia Intelektuale dhe mbikëqyrja e saj në Republikën e Shqipërisë” me studentët e Universitetin jo publik “Marin Barleti” - 23 Shtator 2020.
- Prezantimi në Stacionin Televiziv Scan TV me temë “Sfidat e mbikëqyrjes së Tregut në kohën e pandemisë” - 4 Dhjetor 2020.
- Prezantimi në stacionin Televiziv News 24 mbi mbrojtje e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe sfidat që e shoqërojnë atë - 12 Dhjetor 2020.

Për ndërgjegjësimin e qytetarëve, prodhuesve, tregtarëve, instaluesve, për sigurinë e lodrave dhe të ashensorëve , për njohjen dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale janë realizuar 5 intervista në News 24, Fax News, TV Skampa, etj, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ISHMT-së.



Me mbështetjen e Projektit Europe/137616/IH/SER/AL “Technical Assistance to carry out effective market surveillance” dhe fondet buxhetore të ISHMT-së **janë përkthyer dhe printuar: 2 materiale informuese** të Agjencisë Europiane të Kimikateve (ECHA) lidhur me klasifikimin , etiketimin dhe paketimin e kimikateve

**Është përditësuar** në mënyrë të vazhdueshme **informacioni në web-site** e ISHMT-së [www.ishmt.gov.al](http://www.ishmt.gov.al) , i cili në kuadrin e Projektit “Technical assistance for carrying out efficient market surveillance” është në versionin në gjuhën angleze.

**Përditësimi i rrjeteve sociale** mbi aktivitetet mbikëqyrëse të kryera nga ISHMT në bazë javore, dhe publikimi i informacioneve të dobishme për konsumatorët apo operatorët ekonomik.


## 5. NGRITJA DHE FORCIMI I KAPACITETETEVE

**Në total janë kryer 15 trajnime me pjesëmarrjen e 52 inspektorëve. 40% e inspektorëve janë trajnuar më shumë se dy herë.**

- Trajnim “Playground Safety - Practical Training” në kuadrin e projektit EuropeAid / 137616 / IH / SER / AL “Technical assistance for effective Market Surveillance” - 23 Janar 2020.
- Trajnim mbi mënyrën e funksionimit të spektrometrit dhe mirëmbajtja, i nevojshëm për kryerjen e inspektimeve në vlerësimin e rrezikshmërisë së substancave kimike – 26 Shkurt 2020.
- Trajnim mbi plotësimin e IAGA për kapitujt 1 dhe 28 me mbështetjen e GIZ – 13 Maj 2020.
- Trajnim mbi legjislacionin e ri të BE-së për mbikëqyrjen e tregut, komponentët horizontalë të rregulloreve të reja (EU) 2019/1020 dhe (EU) 2019/515 me mbështetjen e PTB – 27-28 Maj 2020.
- Trajnim mbi kontrollin formal për kategorinë e produkteve elektrike, mekanike, ashensorë, lodra dhe instrumenta matëse në kuadrin e projektit No. EuropeAid / 137616 / IH / SER / AL – 2 Korrik 2020.
- Trajnimi “Asistencë Teknike për të kryer Mbikëqyrjen Efektive të Tregut në përputhje me Acquis” – 3 Korrik 2020.
- Trajnimi mbi legjislacionin e ri të BE-së për mbikëqyrjen e tregut, (EU) 2019/1020 në kuadrin e projektit No. EuropeAid / 137616 / IH / SER / AL – 14 Korrik 2020.
- Trajnim për Rregulloren e RE 2016/425 të BE “Mbikëqyrja e tregut për pajisjet e mbrojtjes personale, të përdorura në kontekstin e pandemisë COVID-19”, Organizuesit PTB SEE QI Project 4: Market Surveillance (MS) Component: Personal protective equipment (PPE) – 15 Korrik 2020.
- Trajnim për “Instrumentet e Peshimit Automatik” realizuar me mbështetjen RINA & TUNAMAR – 7 Gusht 2020.
- Trajnim mbi Mbikëqyrjen e Tregut të Pajisjeve të Mbrojtjes Personale - Legjislacioni i BE + implikime praktike të WB6 organizuar nga projekti PTB më 28-29 Shtator 2020.

- Trajnimi online për Piraterinë Audiovizuale të ofruar nga UL dhe Interpol - Tetor 2020.
- Trajnim online , organizuar nga INTERPOL me teme “Cryptocurrency: Understanding Cryptocurrency-Related IP Crime” – Tetor 2020.
- Kursi i avancuar online me temë “Inteligjenca Artificiale dhe Pronësia Intelektuale” organizuar nga EUIPO - Nëntor 2020.
- Trajnimi “Mbrojtja e të drejtave të pronësisë industriale”, organizuar nga Qendra e Trajnimeve të DPPI – 9 Dhjetor 2020.
- Trajnim mbi përdorimin e sistemit e-inspection , Etika dhe Konflikti i interesit në procesin e inspektimit, organizuar nga ISHMT për inspektorët e rinj të sapo emëruar pranë këtij institucioni në Dhjetor 2020.
- Gjatë vitit 2020 stafi i ISHMT-sw ka marrë pjesë **në 15 trajnime** të organizuar nga ASPA në lidhje me procedurat administrative, prokurimin publik, burimet njerëzore, buxhetin afatmesëm, të drejtën e informimit, etj.

Janë trajnuar inspektorë nga të gjithë sektorët dhe gati **40% e inspektorëve janë trajnuar më shumë se 1 herë.**



## 6. MBËSHTETJE PËR PËRMIRËSIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E VEPRIMTARISË TË ISHMT-SË

Gjatë kësaj periudhe është kontribuar në hartimin e 3 (tre) draft ligjeve, 1(një) draft VKM , 2 rregullore për institucionin dhe në raportimet për Kapitullin 1, 7 dhe 28 si pjesë e GNP.

- ✓ ISHMT ka qenë pjesë e grupit të punës në bashkëpunim me ekspertin ligjor të kontraktuar nga Projekti Europe/137616/IH/SER/AL “Technical Assistance to carry out effective market surveillance”, për **realizimin e ndryshimeve të Ligjit nr.10216 “Për detergjentët”**. Projekt-Ligji është përfunduar dhe është në fazën e publikimit për konsultim publik.
- ✓ Në kuadrin e Projektit Europe/137616/IH/SER/AL “Technical Assistance to carry out effective market surveillance” **u hartua projekt-ligji me ndryshimet e nevojshme të Ligjit 9947 “Për Pronësinë Industriale”**. Ky projekt-ligj ka përfunduar fazën e shqyrtimit ndërministror dhe është dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave. Miratimi i këtij projekt-ligji do t’i krijojë ISHMT-së mundësinë e realizimit të inspektimeve ex-officio dhe jo vetëm mbi bazë ankimi nga mbajtësit e së drejtës.
- ✓ ISHMT është **pjesë e grupit të punës për hartimin e strategjisë së re për pronësinë intelektuale** në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 118, datë 23.09.2020 “Për ngritjen e Grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e dokumentit strategjik për pronësinë intelektuale 2021-2025”.
- ✓ ISHMT në kuadër të përmbushjeve të detyrave të caktuara në **Kapitullin 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”, Kapitullin 7 “Pronësia Intelektuale” dhe Kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik”** si pjesë e GNP, **ka dhënë kontributin** mbi analizën e raportit të Komisionit Europian për mangësitë e konstatuara në kuadër të këtyre kapitujve dhe masat që duhen marrë me qëllim harmonizimin e legjislacionit. Ka koordinuar punën e nëngrupit III si institucion drejtues për institucionet e përfshira në zbatimin e mbrojtjes së të drejtave të PI, si dhe ka kontribuar në hartimin e Draft Metodologjisë së re dhe PKIE 2021-2023.
- ✓ Hartimi dhe miratimi i rregullores se re të ISHMT-së.

## **7. DETYRAT E PAREALIZUARA OSE TË REALIZUARA PJESËRISHT**

### **7.1. Arsyet e mosrealizimit të çështjeve të parashikuara për vitin 2020**

Gjatë vitit 2020 nuk u realizua:

- ✓ **Numri i planifikuar i inspektimeve** dhe kjo për arsye:
  - Të situatës së jashtëzakonshme të krijuar nga Pandemia Covid 19. Nga muaji Mars deri në Dhjetor , inspektorët e ISHMT-së janë angazhuar në kryerjen e kontrolleve të zbatimit të protokolleve të sigurisë anti-Covid si pjesë e Task Forcës.

- Mungesës së mjeteve të transportit për kryerjen e inspektimeve në të gjithë vendin.
  - Shumë subjekte nuk janë gjetur në adresat që kanë deklaruar në QKB, disa kanë ndryshuar objektin e veprimtarisë dhe një pjesë janë gjetur mbyllur.
- ✓ Për sa i përket **buxhetit të miratuar për ISHMT** nga fondi i planifikuar prej 109.800.000 lekë janë shpenzuar 81.508.400 lekë , dmth 74% e buxhetit total është përdorur, sipas tabelës si mëposhtë:

	EMERTIMI	SHUMA (LEKË)
<b>FONDET E CELURA</b>		
600	Paga	59.800.000
601	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	13.000.000
602	Shpenzime korente	28.000.000
231	Investime	9.000.000
<b>TOTALI</b>		<b>109.800.000</b>
<b>FONDET E SHPENZUARA</b>		
600	Paga	48.492.480
601	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	8.024.802
602	Shpenzime korente	17.276.978
231	Investime	7.714.140
<b>TOTALI</b>		<b>81.508.400</b>

Për pagat e punonjësve të ISHMT janë paguar 48.492.480 lekë ose 81 % e totalit të pagave të çelur në fillim të vitit buxhetor 2020 në shumën 59.800.000 lekë.

Po kështu për Sigurimet Shoqërore Shëndetësore dhe Tatimet për pagat e marra nga punonjësit e ISHMT janë paguar 8.024.802 lekë ose 61.73 % e totalit të vitit buxhetor 2020 në shumën 13.000.000 lekë të sigurimeve të çelura në fillim të vitit 2020 .

Për zërin e Investimeve janë përdorur 7.714.140 lekë ose 85.71 % e totalit të vitit buxhetor 2020 në shumën 9.000.000 lekë të çelura në fillim të vitit 2020 .

Nga planifikimi i zërit të investimeve për vitin 2020 janë realizuar investimet e mëposhtme:

- Blerje të pajisjeve dhe instrumentave për testim dhe inspektim në terren në vlerën 5.902.800 lekë me Tvsh.
- Blerje pajisje kompjuterike (kompjuterat dhe laptop) në vlerën 854.940 lekë me Tvsh.
- Blerje pajisje (mobilim zyre ) në vlerën 956.400 lekë me Tvsh.



Nga planifikimi i zërit të investimeve për vitin 2020 nuk është realizuar investimi i mëposhtëm:

- Rikonstruksioni i ambjenteve të ISHMT-së në vlerën 1 000 000 lekë me tvsh. Kjo vlerë është tërhequr nga Buxheti i ISHMT-së me Akt Normativ Nr. 34, datë 16.12.2020.

Për vitin 2020 janë arkëtuar nga gjrobat **3.697.998** lekë.

## **8. BURIMET NJERËZORE**

Gjatë vitit 2020 është verifikuar listëprezenca e nënpunësve rregullisht si dhe është monitoruar zbatimi i Kodit të Etikës. ISHMT ka në organikë 80 punonjës, nga të cilët 72 janë të emëruar dhe 8 pozicione janë vakante.

### **8.1 Disiplina në punë, rekordet e orareve të punës**

Gjatë vitit 2020 është verifikuar listëprezenca e nënpunësve rregullisht dhe sistemi i hyrje-daljeve .

### **8.2 Performanca sipas kritereve**

Me Urdhërin nr. 73, datë 01.06.2020 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut” është miratuar struktura e re e institucionit e përbërë nga 4 njësi organizative (Drejtori), 8 njësi organizative (Sektorë) dhe me gjithësej 80 punonjës (Tab.2). Këtë vit është miratuar Rregullorja e Brendshme e ISHMT-së dhe Rregullorja për ndalimin e pirjes së duhanit në ambjentet e brendshme të institucionit.

Në respektim të udhëzimeve nga Strukturat e Posaçme të Mbrojtjes së Shëndetit Publik, janë ndjekur të gjitha masat për parandalimin e përhapjes së Pandemisë COVID-19, aplikimi i punës online dhe në distancë dhe pajisja e nënpunësve me dezinfektatë dhe mjete mbrojtëse për parandalimin e sëmundjes.

### **8.3 Masa disiplinore të marra**

Për periudhën Janar-Qershor 2020 është ngritur 1 komision disiplinor dhe është marrë 1 (një) masë disiplinore “largim nga shërbimi civil”.

### **8.4 Ngritje në detyrë, lëvizje paralele**

Gjatë vitit 2020 janë kryer: 4 ngritje në detyrë; 6 lëvizje paralele; 16 pranime nga jashtë shërbimit civil; 2 pranime nga ekselencia; 4 emërimet punonjës me kontratë.

### **8.5 Ankesat**

ISHMT gjatë vitit 2020 ka trajtuar **152 ankesa** , 6 prej të cilave kanë ardhur nga bashkëqeverisja, 14 kanë ardhur në e-mail-in e kontaktit të ISHMT-së, 126 janë dorëzuar dorazi në protokollin e ISHMT-së dhe 6 janë deleguar nga institucione të tjera shtetërore. (Tab.3)

## 9. MASAT E NDËRMARRA LIDHUR ME TASK FORCËN E ANTIKORRUPSIONIT

Mbështetur në Vendimin nr.247, datë 20.03.2015 “Për miratimin e Strategjisë ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020”, ISHMT ka marrë këto masa:

1. Ka implementuar portalin online E-Inspektimi;
2. Inspektimi kryhet me kite portabël;
3. Publikimi online i të gjitha akteve nënligjore që parashikojnë procedurat e trajtimit të ankesave dhe afatet (adresa web e aksesueshme);
4. Hartimi i programit të transparencës sipas ligjit për të drejtën e informimit .

## 10. PLANI I PUNËS PËR VITIN 2021

Për vitin 2021 prioritetet e punës së ISHMT-së do të jenë:

### Inspektimet

Fokusi kryesor do të jetë në: A) grup-produktet që kanë rezultuar me problematika të ndryshme në vitet paraardhëse, që kanë një ndjeshmëri në treg si p.sh instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar, parapaketimi, dekodera, karikues, llamba, etj, regjistrimi i ashensorëve në ISHMT, produkte për të cilat deri tani, nuk ka patur veprimtari mbikëqyrëse; B) respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Në vitin 2021 do të realizohen në total **3140 inspektime**, nga të cilat 2317 në fushën e mbikëqyrjes së tregut të produkteve joushqimore dhe 823 inspektime në fushën e pronësisë intelektuale.

Nr.	ISHMT	Numër inspektimesh
<b>1</b>	<b>Drejtoria e Produkteve Joushqimore</b>	<b>2317</b>
1.1	Sektori i Produkteve mekanike	386
1.2	Sektori i Produkteve Elektrike	386
1.3	Sektori i qelqit, këpucëve, detergjentëve/sigurisë së produkteve	386
1.4	Sektori i Inspektimit Metrologjik	1159

<b>2</b>	<b>Drejtoria e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale</b>	<b>823</b>
2.1	Sektor i Pronësisë Industriale	<b>50</b>
2.2	Sektori i të Drejtës së Autorit	<b>773</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>3140</b>

### **Informimi**

- Informimi i operatorëve ekonomikë për zbatimin e kriterëve ligjorë mbi sigurinë e produkteve joushqimore si dhe mbi respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve mbi sigurinë e produkteve dhe mbi të drejtat e tyre si konsumator.

### **Kapacitetet njerëzore**

Trajnime të vazhdueshme të stafit për rritjen e shkallës së njohurive në fushat përkatëse.

### **Bashkëpunimet**

- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe të pronësisë intelektuale.
- Fuqizimi i bashkëpunimit të ISHMT-së me Autoritetet e Mbikëqyrjes së Tregut të vendeve të Rajonit për shkëmbim eksperience dhe të Përvojave më të mira.

## **11. PROBLEMATIKAT**

- Mungesa e automjeteve për inspektim të cilat sjellin vështirësi në realizimin e planit të inspektimeve , duke pasur në konsideratë shtrirjen e gjerë territoriale (i gjithë territori i vendit) të ushtrimit të funksionit të ISHMT-së.
- Mangësi në vlerësimin e sigurisë së produkteve nëpërmjet aparaturave dhe pajisjeve e cila lidhet jo vetëm me numrin shumë të kufizuar të këtyre pajisjeve dhe aparaturave, por edhe me mungesën e trajnimeve më të avancuara për përdorimin e tyre.
- Mungesa e një procedure për produktet që duhet t'i nënshtrohet analizave laboratorike në laboratorë të huaj, duke patur në konsideratë që në Shqipëri ekziston vetëm një laborator i akredituar për analizat e tekstilit dhe lëkurës, ndërsa për produkte të tjera që janë në fokusin e inspektimit të ISHMT-së si : lodra, detergjentë, produkte të kujdesit për fëmijë, etj., analizat duhet të kryhen në laboratore të akredituar të huaj.

- Buxheti i limituar i vënë në dispozicion për këtë inspektorat duke pasur në konsideratë gamën e gjerë të produkteve që mbulon për inspektim si dhe mbulimin e gjerë territorial të vendit.
- Mungesa e përditësimit të adresave të subjekteve në QKB, e cila sjell që shumë inspektime të mos kryhen sepse subjektet nuk gjenden nga inspektorët në adresat që ata kanë deklaruar në QKB.
- Mungesë eksperience e stafit në fushën e inspektimit dhe në fushat specifike që janë në fokusin e ISHMT-së. Shumë prej fushave si siguria e produkteve elektrike, mekanike, qelq/këpuca/detergjentet, pronësia industriale, janë fusha që kërkojnë një staf të trajnuar dhe të formuar profesionalisht.
- Shkalla e ulët e informimit të subjekteve, në lidhje me kuadrin ligjor dhe detyrimet që rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore të miratuar sipas fushave specifike, inspektimi i të cilave është në fokusin e ISHMT-së, është një nga problemet që vështirësojnë së tepërmi punën e ISHMT-së.

Tabela 1: Inspektimet sipas sektorëve dhe grup-produkteve, 2020

	Fushë veprimtaria	Inspektime te planifikuar	Inspektime të kryera	Masa administrative gjithsej	Gjoha	Paralajmërimë	Masa urgjente	numër produktesh të kontrolluara	Numër produktesh të kontrolluara jo në konformitet
<b>1</b>	<b>Inspektimi Metrologjik</b>	<b>1656</b>	<b>542</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>2997</b>	<b>39</b>
1.1	<i>Parapaketim</i>		360	1	1	0	0	1229	1
1.2	<i>Instrumentat matëse ligjërish të kontrolluara</i>		182	3	2	1	0	1768	38
<b>2</b>	<b>Inspektimi i produkteve elektrike</b>	<b>552</b>	<b>78</b>	<b>11</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>4798</b>	<b>40</b>
<b>3</b>	<b>Inspektimi i produkteve/pajisjeve mekanike (ashensorë, PMP, makineri)</b>	<b>552</b>	<b>463</b>	<b>233</b>	<b>13</b>	<b>219</b>	<b>1</b>	<b>696</b>	<b>337</b>
3.1	<i>Ashensorë</i>		425	230	13	216	1	610	337
3.2	<i>Makineri</i>		38	3	0	3	0	86	0
<b>4</b>	<b>Inspektimi i produkteve qelq/këpucë/sig produkteve (lodra, tekstil, veshje këmbe)</b>	<b>552</b>	<b>170</b>	<b>34</b>	<b>7</b>	<b>9</b>	<b>18</b>	<b>1282</b>	<b>75</b>
4.1	<i>Lodra</i>		48	25	7	0	18	582	40
4.2	<i>Detergjentë</i>		36	2	0	2	0	174	12
4.3	<i>Veshje këmbe</i>		33	3	0	3	0	350	9
4.4	<i>Mbrojtja e konsumatorit</i>		26	2	0	2	0	8	4
4.5	<i>Siguria e përgjithshme</i>		27	2	0	2	0	168	10
<b>5</b>	<b>E drejta e autorit dhe të drejtat e tjera lidhur me to</b>	<b>828</b>	<b>384</b>	<b>28</b>	<b>13</b>	<b>15</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>6</b>	<b>Inspektimi për të drejtat e Pronësisë Industriale</b>	<b>100</b>	<b>12</b>	<b>8</b>	<b>8</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>4240</b>	<b>1649</b>	<b>318</b>	<b>45</b>	<b>249</b>	<b>24</b>	<b>9773</b>	<b>491</b>

**Tabela 2: Staffi i ISHMTsë sipas sektorëve dhe drejtorive**

	Numri i punonjësve sipas strukturës së miratuar <sup>13</sup>	Numri aktual i punonjësve	%	Numri i punonjësve sipas strukturës së miratuar <sup>14</sup>	Numri aktual i punonjësve	%				
							Janar 2020		Dhjetor 2020	
<b>DREJTORIA TEKNIKE</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>60</b>	<b>7</b>	<b>6</b>	<b>86</b>				
<b>DREJTORIA E MBIKËQYRJES SE PRODUKTEVE</b>	<b>35</b>	<b>27</b>	<b>77</b>	<b>42</b>	<b>37</b>	<b>88</b>				
Sektori I Produkteve Elektrike	7	4	57	7	6	86				
Sektori I Produkteve Mekanike	6	4	67	9	6	67				
Sektori I Metrologjisë	16	13	81	16	15	94				
Sektori Kimik dhe Siguria e Përgjithshme	6	5	83	9	9	100				
<b>DREJTORIA E PRONESISE INTELEKTUALE</b>	<b>17</b>	<b>14</b>	<b>82</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>100%</b>				
Sektori I Pronësisë Industriale	8	4	50	7	7	100				
Sektori I të Drejtave të Autorit	9	9	100	10	10	100				
<b>DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>	<b>12</b>	<b>8</b>	<b>67</b>	<b>12</b>	<b>10</b>	<b>83%</b>				
Sektori juridik dhe shërbimeve mbështetëse	0	0	0	8	8	100				
Sektori I Financës	0	0	0	3	2	67				
	<b>69</b>	<b>52</b>	<b>75%</b>	<b>80</b>	<b>72</b>	<b>90%</b>				

**Tabela 3: Numër ankesash të trajtuara nga ISHMT, 2020**

Nr	Institucioni/Organi/	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	TOTALI
1	Ankesa nga Bashkëqeverisja											1	5	6
2	ankesa - \web site ISHMT/e-mail zyrtar		2		1			1	2	3	2		3	14
3	Ankesa dorëzuar në protokoll ISHMT	6	3	2	2	7	8	9	6	12	15	17	39	126
4	Ankesa deleguar nga institucione të tjera	2						1			1		2	6
	<b>TOTALI</b>	<b>8</b>	<b>5</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>11</b>	<b>8</b>	<b>15</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>49</b>	<b>152</b>

<sup>13</sup> Urdhër i Kryeministrit Nr.107, datë 31.07.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”.

<sup>14</sup> Urdhër i Kryeministrit Nr.73, datë 01.06.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”

